

## **AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS**

Në përputhje me autorizimin e dhënë me nenin 17 b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 1 tetor 2001 për ndryshimin e Rregullores 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 të datës 5 tetor 2001 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësve të sigurimit,

Me qëllim zbatimi të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25,

Këshilli Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2002, miratoi:

:

### **Rregullën 1 mbi përkufizimin dhe interpretimin, rregullat e përgjithshme**

**Emërtimi** Kjo Rregull mund të emërtohet Rregullat e sigurimit të Kosovës ose Rregullat e sigurimit.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 25/2001 mund të quhet Rregullorja e sigurimit të Kosovës ose Rregullorja e sigurimit.

### **Neni 1 Përkufizimet**

Termet e përmendur dhe të përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së sigurimit do të kenë kuptimin e tyre të përgjithshëm siç është përcaktuar aty dhe do të interpretohen ashtu, përveç nëse konteksti ka domethënie tjetër, në pajtim me nenin 2 të kësaj Rregulle.

## **Neni 2** **Interpretimi**

Në këtë rregull, termat dhe shprehjet e mëposhtme, përveç nëse konteksti ka kuptim tjetër, kanë këto domethënie:

“Sigurim i aksidentit” do të thotë sigurimi kundër lëndimit, vdekjes ose paaftësisë si pasojë e një aksidenti që siguron përfitime të caktuara financiare ose përfitime me karakter të dëmshpërblimit (apo kombinim i të dyjave).

“Vdekja aksidentale dhe gjymtimi” është vdekja që vjen nga, ose si pasojë e aksidentit dhe/ose humbja dhe copëtimi i gjymtyrëve ose pjesëve të trupit të përmendura në polisë.

“Shpenzimet e krijuara” në lidhje me sigurimin jetësor, do të thotë shpenzimet e shkaktuara në përfitimin e polisave të reja të sigurimit dhe kontratave të anuitetit. Përfshin vetëm ato shpenzime që ndryshojnë dhe janë kryesisht të lidhura me polisat dhe kontratat. (p.sh. provizionet, disa shpenzime të polisave dhe të nënshkuara dhe kuotat medicinale). Sa i përket sigurimit të përgjithshëm, shpenzimet e krijuara janë të gjitha shpenzimet në lidhje me paraqitjen e biznesit të ri apo vazhdimin e biznesit, duke përfshirë veçanërisht shpenzimet e caktuara dhe të identifikuar lidhur me provizionet, shtesat, ndihmat dhe kompensimet e tjera të paguara agjentëve dhe brokerëve (ndërmjetësve).

“Premia aktuale” do të thotë primi i përcaktuar në polisë apo çdo prim i kontraktuar më pas nga poseduesi i polisës dhe kompania e sigurimit si mbulesë shtesë.

“Detyrimet aktuariale” do të thotë vlera aktuale e llogaritur e shpenzimeve dhe e përfitimeve të polisës, pa vlerën aktuale të premive të ardhshme (të rregulluara për dispozitën për shmangie të pafavorshme) dhe është masë e shumave, të cilat së bashku me premitë e ardhshme dhe të hyrat nga investimet, do të kërkohen nga kompania për sigurim jetësor për t’i shlyer detyrimet e veta sipas polisave të veta të sigurimit dhe kontratave të anuitetit dhe për të paguar shpenzimet administrative të atyre polisave dhe kontratave.

“Rezervat shtesë” do të thotë rezervat neto të kërkuara në lidhje me kategorinë e sigurimit të biznesit.

“Sigurimi për aeroplan” do të thotë sigurimi kundër:

(1) përgjegjësisë që rrjedh nga lëndimet trupore, vdekja e personit, apo humbja, dëmtimi i pronës, shkaktuar nga aeroplani ose nga shfrytëzimi apo veprimi i tij, ose

(2) humbjes ose dëmtimit të aeroplanit;

“Metoda e amortizimit të shpenzimeve” do të thotë një metodë llogaritëse, me të cilën shpenzimet historike të afatit të caktuar të investimit rregullohen sistematikisht gjatë periudhës në të cilën investimi mbahet për shumën që pritet të realizohet me kalimin e afatit. Vlera e investimit në çfarëdo kohe gjatë periudhës deri te kalimi i afatit është vlerë e amortizuar/ shlyer.

“Anuitetet” do të thotë kontratat me të cilat siguruesi ia paguan të siguruarit një shumë ose një varg shumash në të ardhmen si kompensim për një a më shumë premi të paguara.

“Kompania pretenduese” do të thotë risiguruesi në transakcion risigurues. Kompania pretenduese është e obliguar t’i kompensojë kompanisë ceduese dëmet e bëra në bazë të marrëveshjes dhe kushteve të kontratës risiguruese.

“Sigurimi automobilistik” ose “autosigurimi” përfshin autosigurimin e pronarëve, shfrytëzuesve, tregtarëve të automobilave apo të tjerëve me kamatë sigurimi kundër incidenteve të rrezikshme ndaj pronësisë, mirëmbajtjes, punës dhe shfrytëzimit të automobilave.

“Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës” ose “BPK” i referohet organit të autorizuar kontrollues kompetent për rregullimin dhe mbikëqyrjen e drejtimit të bizneseve të sigurimit në Kosovë.

“Përfituesi” do të thotë personi ose personat që gëzojnë të drejtën të marrin të ardhurat/përfitimet nga sigurimi.

“**Boiler** sigurimi” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë nga lëndimi trupor, vdekja e personit, humbja ose dëmtimi i pronës, shkaktuar nga eksplozimi, prishja apo aksidenti për shkak të presionit të anijeve të çfarëdo kategorie, motorëve dhe makinerisë lidhur me këtë apo që punojnë pranë.

“Obligacioni ose kontrata garantuese” do të thotë garacia që i përket kategorisë së sigurimit në mirëbesim dhe sigurisë në sigurim.

“Vlera e të hollave të gatshme pas dorëzimit” do të thotë vlera që duhet t’i paguhet poseduesit të polisës nëse dorëzohet polisa.

“Vlera e të hollave të gatshme të deficitit” do të thotë ndryshimi absolut në rastet kur detyrimi i polisës është më i madh sesa vlera e dorëzimit të polisës.

“Cedimi” do të thotë kalimi i të gjitha apo disa rreziqeve të sigurimit prej një siguruesi në tjetrin.

“Sigurimi civil nga trazirat” do të thotë sigurimi ndaj humbjes apo dëmtimit të pasurisë që shkaktohet nga bombarbimi, pushtimi, kryengritja, rebelimi, lufta qytetare, trazirat civile që nuk rrjedhin nga veprimet e armikut të jashtëm, operacioneve luftënxitëse ose luftarake (pavarësisht nga ajo se a është shpallur luftë apo jo), revolucioni, komploti, forcat pushtuese apo ushtarake, opeacionet e flotës apo forcave ajrore, vandalizmi apo dëmet e shkaktuara nga smira dhe dashakeqësia.

“Kërkesat e rregullimit të dëmeve” do të thotë shpërblimet, honoraret që u paguhen profesionalistëve për kompensimin e dëmeve, përfshirë shpenzimet e natyrës së ngjashme që janë të lidhura drejtpërsëdrejti me kompensimin e dëmeve.

“Dëmet e pësuar por jo të raportuara” do të thotë dëmet e pësuar para ose gjatë periudhës llogaritëse, por që nuk i janë raportuar kompanisë së sigurimeve në fund të vitit financiar të saj.

“Dëmet e papaguara” do të thotë shuma e vënë mënjanë në fund të vitit financiar të kompanisë së sigurimeve për t’i përballuar dëmet sipas kontratës së sigurimit, lidhur me incidentet që ndodhin para fundit të atij viti financiar, të cilat nuk janë paguar (përfshirë dëmet, shuma e të cilave nuk është përcaktuar dhe dëmet që vijnë nga incidentet të cilat nuk kanë qenë të njohura për kompaninë) dhe për të përballuar shpenzimet që mund të dalin në lidhje me rregullimin e dëmeve të tilla.

“Provizionet – absolute” do të thotë provizionet e paguara drejtuesve të agjencisë për sigurim jetësor, bazuar në përqindjet e kontraktuara për provizionet e fituara nga agjentët nën mbikëqyrje.

“Provizionet – zëvendësuese” do të thotë pagesat e bëra me përfundimin e kontratës së agjentit, nënagjentit ose ndërmjetësit derisa provizionet e ardhshme në premi vazhdojnë të mblidhen, llogariten me një formulë të pajtuar dhe i paguhen agjentit në shumë paushale.

“Sigurimi i kontraktuesit nga të gjitha rreziqet” do të thotë sigurimi kundër humbjes si rezultat i zjarrit dhe rreziqeve të tjera të veçanta në lidhje me punët e përkohshme dhe të përhershme gjatë ndërtimit.

“Sigurimi kreditor” do të thotë sigurimi kundër humbjes së personit me ç’rast humbja është rezultat i falimentimit apo mospagesës nga ana e personit kredimarrës, pa përfshirë sigurimin nga kategoria e sigurimit hipotekar.

“Sigurimi në prodhim” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të prodhimit si rezultat i zjarrit, tufanit, thatësisë, përmbysjes, sëmundjes dhe rreziqeve të tjera.

“Dëmshtëpërblimi i vdekjes” do të thotë shuma të cilën i siguruari sipas polisës për sigurim jetësor bashkë me të gjitha përfitimet tjera të mbledhura që janë për t’iu paguar shfrytëzuesit (përfituesit) me vdekjen e të siguarit.

“Depozitat” do të thotë shumat e mbledhura nga kompanitë për sigurim jetësor, në të cilat ata u paguajnë kamatë poseduesve të polisës, por nuk janë pagesa për sigurim nga rreziqet as janë të lidhura me shërbimet e bëra poseduesve të polisës.

“Sigurimi nga përgjegjësia për drejtorët dhe nëpunësit” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë së drejtorëve dhe nëpunësve të kompanisë, partneritetit, shoqërisë ose korporatës në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre ligjore si drejtorë dhe nëpunës të kompanive.

“Sigurimi nga termeti” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë që shkaktohen prej termetit ose lëvizjeve të natyrshme nëntokësore.

“Përgjegjësia e punëdhënësit” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë që rrjedh nga lëndimet trupore, paaftësia ose vdekja e punëtorit të të siguarit që ndodh si rezultat i punës ose gjatë punës së punëtorit.

“Polisat e përziera” do të thotë polisat me afat të përcaktuar, për të cilat shuma e garantuar paguhet me të vdekur të poseduesit të polisës ose me të kaluar të afatit të polisës edhe nëse poseduesi i polisës është gjallë.

“Investimet në vlerën e mbetur” do të thotë investimet pa datë të skadimit ose pa garanci të kthimit të investimeve, përfshirë investimet në aksionet e rregullta, aksionet e preferuara pa datë të caktuar të shpërblimit dhe në njësitë e mirëbesimit (fondet e përbashkëta).

“Fondet e lidhura të njësisë” do të thotë fonde të veçanta që i formojë kompanitë e sigurimit të jetës në përputhje me këto rregulla, për të administruar premittë marra nga poseduesit e polisave lidhur me pjesën e investuar në planin për sigurim të jetës.

“Sigurimi i lidhur i njësisë” do të thotë sigurimi i bërë nëpërmjet kontratave të sigurimit që përfshijnë përfitimet të cilat janë tërësisht ose pjesërisht të lidhura me të hyrat nga ose vlera e ndonjë grupi specifik të pasurisë së kompanisë ose tërësisht apo pjesërisht të llogaritura duke iu referuar të hyrave ose vlerës së një investimi specifik, qofshin investime të mbajtura nga kompania apo jo.

“Sigurimi nga eksplozimi” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë shkaktuar nga eksplozimi dhe përfshin sigurimin që i përket kategorisë së sigurimit civil nga trazirat.

“Rrëzimi i aeroplanit” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pronës shkaktuar nga aeroplani apo nga ndonjë objekt që bie nga aeroplani.

“Sigurimi i mirëbesimit” do të thotë sigurimi kundër humbjes së shkaktuar nga kryerja e pabesë e detyrave nga personi në mirëbesim, ose sigurimi kur siguruesi garanton përmbushjen e duhur të detyrave në zyrë.

“Sigurimi nga zjarri” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë shkaktuar nga zjarri, djegia, eksplozimi për shkak të djegies, duhanit si dhe nga thyerja ose rrjedhja e spërkatësit ose sistemeve të tjera të mbrojtjes nga zjarri.

“Afat i caktuar, investimet me kamatë të caktuar” do të thotë investimet e karakterizuara nga datat e caktuara si data fiks të kalimit të afatit për kthimin e kapitalit dhe kamatës. Kamatat mund t’u paguhen investitorëve në datat e përcaktuara në kushtet e kontratës. Investitori zakonisht nuk ka kërkesa kundër investimit përpos atyre të paraqitura në kontratë.

“Sigurimi nga falsifikimi” do të thotë sigurimi kundër humbjes së shkaktuar nga falsifikimi.

“Fondi i përgjithshëm” do të thotë fondi kryesor i kompanisë për sigurim jetësor, që u përket edhe aksionarëve, edhe poseduesve të polisave, mirëpo nuk përfshin pasurinë (mjetet), detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e fondeve të veçanta.

“Afat i pritjes” do të thotë periudha (zakonisht 31 ditë), gjatë së cilës pritet arritja e primit të papaguar dhe polisa me të gjitha shtesat mbetet në fuqi.

“Premitë bruto” do të thotë premitë pas zbritjes së rimbursimeve dhe skontos së premive e para zbritjes së premive për risigurimin dhe provizionit që duhet paguar kompanisë.

“Sigurimi kolektiv” do të thotë sigurimi i veçantë i jetëve apo shëndetit të një grupi personash me një kontratë në mes të siguruesit dhe punëdhënësit ose ndonjë personi tjetër të pranueshëm garantues.

“Sigurimi garantues” do të thotë sigurimi që i përket kategorisë së sigurimit të aftësisë kredituese ose garantimit të sigurimit.

“Sigurimi nga breshri” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të prodhimit në fushë.

“Dëmet shëndetësore” do të thotë dëmet e paguara me kontratë për sigurim shëndetësor qoftë kur të siguruarit apo anëtarët e programit kompensohen, qoftë kur ofruesit e shërbimeve shëndetësore paguhen drejtpërsëdrejti nga kompania e sigurimit.

“Sigurimi nga stuhia dhe tufani” do të thotë sigurimi kundër humbjes apo dëmtimit të pronës shkaktuar nga tufani, cikloni, stuhia apo tornadoja.

“Sigurimi nga transporti i brendshëm” do të thotë sigurimi nga humbja ose dëmtimi i pasurisë gjatë incidenteve apo vonesave, pa përfshirë sigurimin që i përket kategorisë së marinës dhe sigurimit transportues.

“Rastet e sigurueshme” do të thotë ndonjë rast apo ngjarje e panjohur, qoftë e kaluar apo e ardhshme, që mund të zhdukë një person që ka interes të siguruar, ose krijon detyrim kundër tij. Ngjarjet e tilla mund të sigurohen në pajtim me dispozitat e këtyre rregullave.

“Interesi jetik që mund të sigurohet” do të thotë që çdo person që ka interes jetik e shëndetësor që mund të sigurohet:

- a) për veten,
- b) çdo person prej të cilit ai varet tërësisht apo në pjesë të arsimimit dhe përkrahjes,
- c) çdo person me obligim ligjor ndaj tij për pagesën e të hollave ose pronës e shërbimeve përkatëse, vdekja apo sëmundja e të cilit mund ta shtyjë ose ndalojë përmbushjen e obligimit.
- d) çdo person, nga jeta e të cilit varet ndonjë pronë ose interes i autorizuar në të.

“Interesi i siguruar në pronë” do të thotë çdo interes në pronë, marrëdhënie ose përgjegjësi në lidhje me të ose që ka karakter të tillë që një rrezik i parashikuar mund ta dëmtojë drejtpërsëdrejti të siguruarin. Përbërësit e tij janë:

- a) interesi ekzistues, ose
- b) interesi i posafilluar që ka lindur nga interesi ekzistues, ose
- c) trashëgimia, bashkë me interesin ekzistues, nga i cili trashëgimia ngritet.

“Rregullorja e sigurimit” ose “rregullorja” i referohet Rregullores së UNMIK-ut nr.25/2001 dhe ndryshimeve e plotësimeve vijuese të saj:

“Rregullat e sigurimit” ose “rregullat” i referohen kësaj rregulle dhe të gjitha rregullave të miratuara dhe të lëshuara nga BPK-ja për zbatimin e Rregullores së sigurimit.

“Rezerva e investuar” do të thotë grumbullimi i të gjitha shumave rezervë për të ardhurat e realizuara dhe të porealizuara në portofolin (aksionet) e investimeve.

“Skadimi” do të thotë përfundimi i polisës së sigurimit për shkak se premia vijuese(e përtëritur) nuk është paguar brenda afatit të fundit.

“Pagesa e sigurimit ligjor” do të thotë sigurimi kundër pagesës nga personi ose personat për shërbime ligjore specifike, përfshirë shpërblimet ose pagesat e tjera për shërbime të tilla.

“Sigurimi nga shpifjet dhe akuzat publike” ose “sigurimi për fyerje personale” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë ligjore për kërkesat e dëmshpërblimit dhe shpenzimet e paditësve në lidhje dëmet e bëra kundër të siguruarit për shpifje, akuza publike, përgojime, arrestime joligjore, konfiskim joligjor të pronës ose e drejta në pronë, shkelja e markës së fabrikës, planet e licencuara, e drejta e autorit ose e patentës.

“Sigurimi jetësor” do të thotë dhe përfshin sigurimin e jetëve të personave ose atyre që kanë të bëjnë me ta, ose të drejtën e fituar, blerjen ose shitjen e anuiteteve.

“Sigurimi i bagëtisë” do të thotë sigurimi kundër humbjes, sëmundjes, ngordhjes ose lëndimit të kafshëve, zogjve dhe peshqve.

“Sigurimi makinerik” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë si rezultat i lëndimeve trupore, vdekjes së personit, ose humbja apo dëmtimi i pasurisë shkaktuar nga avaria e makinerive.

“Rezerva për shmangiet e pavolitshme” do të thotë elementet e supozuara në llogaritjet e përgjegjësisë aktuariale për shmangie të pafavorshme që mund të ndodhin.

“Arritja e përfitimit” do të thotë të ardhurat e polisës nga skadimi i kontratës ose polisës së përzier para vdekjes së të siguruarit ose kur vlera e të hollave arrin vlerën e njëjtë me përfitimin për vdekje dhe i siguruari ka të drejtën të marrë pagesën e plotë të shumës së siguar.

“Minimumi i kapitalit të vazhdueshëm dhe i tepricës për pagesa të kërkuara” është shuma e kërkuar e kapitalit dhe suficitit që siguresit jetësorë dhe shëndetësorë e ruajnë si nivel minimal që të mund të konsiderohen të aftë për të paguar.

“Testi për pasuri minimale” është masa e solventitetit të siguresve për t’u siguar se ata kanë pasuri, kapital dhe suficit minimal për pagesa.



“Sigurimi hipotekar” do të thotë sigurimi kundër humbjes së shkaktuar nga pakujdesia e huamarrësit nën hua të siguruar nga hipoteka me pasuri të patundshme, pengdhënie të pronës së patundshme ose kamatë në pronën e patundshme.

“Rezervat negative” lindin atëherë kur përgjegjësia e polisës, siç është llogaritur në vlerësimet e supozuara, është negative ose nën zero.

“Sigurimi nga vetëdëmtimi” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të automjetit të siguruar për ndeshje aksidentale, përmbysje, zjarr, eksplozim të jashtëm, vjedhje, akte të paramenduara, vërshim, uragan, termet ose dridhje natyrore tjetër, trazira dhe rebelime civile.

“Sigurimi i përhershëm shëndetësor” do të thotë sigurimi kundër rreziqeve të lëndimeve të personit të siguruar si pasojë e fatkeqësisë ose ndonjë aksidenti të kategorisë specifike, ose mbetet i paaftë si pasojë e sëmundjes së kategorisë specifike, me kontratë që:

- a) janë theksuar të kenë ndikim në periudhën prej jo më pak se pesë vite ose pa kufizim kohor, dhe
- b) nuk janë theksuar që të jenë të pezullueshme nga siguruesi para përfundimit të pesë (5) viteve nga data në fuqi, përveç në raste specifike të përmendura në kontratë.

“Sigurimi i përgjegjësisë personale” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë ligjore të të siguruarit dhe anëtarëve të familjes, të cilët zakonisht banojnë me të për të kompensuar palët e treta për lëndim, sëmundje, humbje ose dëmtim të pronës si rrjedhë e aktiviteteve të tyre private jashtë shtëpisë.

“Sigurimi i pronës personale” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pronës personale ose të pasurisë së luajtshme duke mos përfshirë sigurimin nga kategoria e sigurimit automobilistik dhe për aeroplan.

“Sigurimi nga xhami i trashë” do të thotë sigurimi kundër thyerjes së xhamit.

“Polisa” do të thotë dokumenti me të cilin kontrata e sigurimit paraqitet/tregohet për t’u shikuar.

“Dividendi i polisës” do të thotë pagesat vjetore që u bëhen poseduesve të polisës për pjesëmarrje në poliset e sigurimit ku i siguruari jetësor ndan një përqindje të fitimit nga këto polisa për poseduesit e polisiës si dividend.

“Huat e polisës” do të thotë huat për poseduesit e polisave, të siguruara nga vlera e të hollave pas dorëzimit të polisës së sigurimit jetësor.

“Prim” do të thotë premia bruto që mund të merret nga poseduesi i polisës për polisë të sigurimit nga siguruesi. Premitë përfshijnë pagesën e anuiteteve në çfarëdo dendurie të pranuar nga siguruesi.

“Primi – përkatës dhe i papaguar” do të thotë primi që i takon dhe mbetet i papaguar në fund të periudhës llogaritëse.

“Primi – viti i parë” do të thotë primi që duhet marrë në vitin e parë të polisës së re.

“Primi, forma e parë” do të thotë primi i parë i marrë për polisë të re.

“Primi bruto i shkruar” ose “primi bruto” do të thotë primi bruto që është për t’u marrë për polisë të sigurimit nga siguruesi, tatimet neto të primit, rregulluar për prim kthyes ose shtesë, por para zbritjes për provizion, ndërmjetësi ose shpenzime të tjera të fitimit.

“Primi neto i shkruar” do të thotë primi neto që është për t’u marrë në polisë të sigurimit pa primin për risigurimin e ceduar.

“Primi – fitimi neto” ose “fitimi neto prim” do të thotë neto primi i shkruar pa provizion për premitë rezervë të pafituara gjatë periudhës llogaritëse.

“Primi – i përtëritur” ose “përtëritja e primit” do të thotë primi që është për t’u marrë pas vitit të parë të polisës.

“Primi i veçantë” do të thotë primi që i takon sipas polisës së sigurimit ku i gjithë primi paguhet në fillim.

“Premitë e paguara përpara” ose “premitë paraprake” do të thotë premitë e paguara në një apo më shumë këste duke mbuluar më shumë se një periudhë modale.

“Sigurimi i përgjegjësive për produkt” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësive që vjen nga prodhuesit, riparuesit, ose shitësit me pakicë që nga lëndimi trupor e deri te vdekja e personit ose humbja apo dëmtimi i pronës shkaktuar nga produktet e bëra, të shitura ose të shpërndara prej tyre.

“Sigurimi profesional dëmshpërblyes” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësive ligjore ndaj palëve të treta për lëndim, humbje ose dëmtim, që vjen nga neglizhenca, gabimi a mangësia profesionale e e një profesionalisti ose nga punëtorët e tij.

“Dispozita për shmangie të pavolitshme” do të thotë diferenca në mes të përgjegjësive aktuariale të llogaritura duke shfrytëzuar supozimet me ose pa diferencat për devijime të pafavorshme.

“Sigurimi i shërbimeve komunale” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë që vjen nga lëndimet trupore ose vdekja e personit apo humbja ose dëmtimi i pronës që ndodh në lidhje me ushtrimin e biznesit të kompanisë për shërbime komunale, por nuk përfshin sigurimin që i përket kategorisë së sigurimit të aeroplanit, sigurimit automobilistik ose sigurimit të përgjegjësive së punëdhënësit.

“Sigurimi i pasurisë së patundshme” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë së patundshme që rezulton nga ndonjë shkak ose rrezik, që nuk mbulohet në mënyrë specifike në kategoritë tjera të sigurimit duke mbuluar pronën e patundshme.

“Risigurimi” do të thotë supozimi nga një sigurues i të gjitha ose disa rreziqeve të marra përsipër nga siguruesi tjetër për pagesën e primit ku siguruesi i parë (burimor) mbetet plotësisht përgjegjës ndaj të siguruarve, por ka të drejtën e kompensimit (kthimit të parave) nga risiguruesi deri në atë nivel të shumës së të risiguarit.

“Risigurimi, automatik” ndodh atëherë kur kompania ceduese pajtohet të risigurojë të gjitha rastet që ndeshen me kushte të caktuara specifike për shumat e përcaktuara në kontratën e risigurimit.

“Sigurimi fakultativ” i referohet marrëveshjes ku risigurimi bëhet individualisht dhe me efekt vetëm kur miratohet nga risiguruesi. Përfshin marrëveshjet risiguroese ku kompania ceduese zhdëmtohet me një përqindje të polisës specifike të sigurimit ose për humbjet në tejkalimin e retencionit të vet në lidhje me një rrezik të veçantë. Kompania ceduese jep ofertën për risigurim dhe risiguruesi ka mundësinë të pranojë ose të refuzojë rrezikun dhe të caktojë kushtet për pranim. Kushtet e marrëveshjes dhe premit përcaktohen në mënyrë individuale.

“Risigurimi joproportional” ( i quajtur ndryshe “tejkalimi i humbjes”) do të thotë risigurimi kur risiguruesi, duke iu nënshtruar kufizimeve specifike, zhdëmton kompaninë ceduese kundër dëmit në tejkalimin e retencionit specifik.

“Risigurimi proporcional” do të thotë risigurimi ku risiguruesi ndan në mënyrë proporcionale dëmet dhe premitë e kompanisë tjetërsuese.

“Risigurimi traktat” do të thotë marrëveshje e shkruar në mes të siguruesit dhe risiguruesit që përcakton kushtet dhe periudhën për paraqitjen e rreziqeve për risigurim. Marrëveshja zakonisht përfshin një kategori apo klasë të biznesit, ku siguruesi cedues vazhdon të kryejë funksionet administrative të polisës dhe marrëveshjet me të siguarit.

“Kufiri i retencionit” do të thotë shuma maksimale e sigurimit që një kompani siguruese do të mbajë në rrezikun e vet në sigurim jetësor të vetëm ose rrezikun në kategoritë e sigurimit.

“Ricedimi” do të thotë kalimi i detyrimeve të risigurimit nga një risigurues tek të tjerët.

“Fondet e veçanta” do të thotë fondet e veçanta të krijuara për qëllime specifike të ndarjes së pasurisë dhe përgjegjësisë së poseduesve të kontratës (p.sh. të siguruarit ose klientët e fondit pensional) nga fondi i përgjithshëm i kompanisë për sigurim jetësor.

Këto fonde u takojnë poseduesve të kontratës, kështu që kompania për sigurim jetësor është vetëm administrator.

“Shpenzimet e shitjes” paraqesin koston e përgjithshme të rregullimit të mjeteve investuese, për shembull, pagesat e agjentëve, tatimi transferues dhe taksat administrative.

“Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi nga sëmundja” do të thotë:

- a) Sigurimi kundër humbjes si rezultat i sëmundjes ose paaftësisë së personit, përveç humbjes si rezultat i vdekjes, ose
- b) Sigurimi kur siguruesi paguan një shumë ose shuma të hollave në rast të sëmundjes, ose
- c) Sigurimi për paaftësinë e personit, ose kundër shpenzimeve të bëra për kujdesin për sytë ose dhëmbët, shërbimet laboratorike ose të rendgenit, shtrirjen në spital, përveç sëmundjes apo paaftësisë që vjen nga aksidenti.

“Shuma e garantuar” është shuma që kompania e sigurimit jetësor premtos t’i paguajë poseduesit të polisës pas vdekjes ose me kalimin e afatit të polisës së sigurimit.

“Sigurimi i garantuar” do të thotë sigurimi ku siguruesi garanton përmbushjen e duhur të kontratës ose marrëveshjes, ose pagesën e dënimit a dëmshpërblimit për çfarëdo pakujdesie (mospërmbushje të detyrimeve), por nuk përfshin sigurimin nga kategoria e sigurimit kreditor ose sigurimit hipotekar.

“Fondi pensional (fond administrativ depozitor)” do të thotë fondi pensional i drejtuar nga kompania për sigurim jetësor që financohet nga depozitat e poseduesve të kontratave,

ku mjetet e fituara me depozitat përbashkohen me mjetet e kompanisë për sigurim jetësor dhe nuk vendosen në fond të veçantë. (Siguruesi paguan kamtën e klientëve pensionalë në depozitat e tyre).

“Dorëzimi” do të thotë përfundimi i polisës së të siguarit, jo me skadim para datës së kalimit të afatit.

“Sigurimi i vjedhjes” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë shkaktuar nga vjedhja, këmbimi jo i drejtë, vjedhje me thyerje, vjedhje të shtëpisë ose plaçkitje dhe përfshin sigurimin ndaj humbjes së shkaktuar me falsifikim.

“Sigurimi i palës së tretë” do të thotë sigurimi kundër përgjegjësisë ligjore të të siguarit për të depozituar në rast të vdekjes ose lëndimit trupor, ose dëmtimit të pronës, të palëve të treta.

”Sigurimi i titullit” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit shkaktuar nga:

- a) dëmtimi në titullin e pronës së patundshme,
- b) ekzistimi i pengmarrjes, ngarkesës ose shërbimit të detyruar (servitutës) në pasurinë e patundshme,
- c) mangësia në ekzekutimin e hipotekës, në vendosjen e hipotekës, ose kontrata e mirëbesimit lidhur me pronën e patundshme, ose
- d) çdo çështje tjetër që dëmton (prek) titullin e pronës së patundshme ose të drejtën e shfrytëzimit dhe zotërimin e pasurisë së paluajtshme.

“Premitë e pafituara” do të thotë shuma e veçuar në fund të periudhës fiskale ose vitit fiskal nga kompania siguruese nga premitë lidhur me rreziqet që mund të lindin nga kompania pas fundit të periudhës ose vitit financiar, që dalin nga kontratat e sigurimit të përfunduara para fundit të vitit ose periudhës financiare.

“Rezerva për rreziqe të pashuara” është krijuar për rastet kur vlera e pritur e dëmeve dhe për shërbime tjera relevante, qofshin ato të raportuara apo jo, që mund të lidhen me peridhat e pambaruara të polisave në fuqi, në balancim e tejkalon shumën e siguruar për rezervat e premive të pafituara, pas zbritjes së ndonjë shpenzimi të shtyrë që është marrë përsipër.

“Rreziqet e pambaruara” do të thotë shuma e veçuar në fund të vitit financiar nga kompania siguruese si shtesë për premitë e pafituara, lidhur me rreziqet që mund të lindin nga kompania pas fundit të atij viti nën kontratat e sigurimit të përfunduara para fundit të atij viti.

“Tërheqja e të hollave nga njësia” do të thotë tërheqja e vlerës së njësisë nga poseduesi i polisës së njësisë të lidhura të sigurimit jetësor.

“Supozimi vlerësues” do të thotë supozimi ose parashikimi e ngjarjeve në të ardhmen (p.sh. shkalla e vdekshmërisë dhe shkalla e të hyrave në të ardhmen) që përfshin rezervën për devijime të pafavorshme dhe përdoret në llogaritjen e përgjegjësive aktuariale.

“Sigurimi vullkanik” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pronës si pasojë e erupcionit vullkanik.

“Sigurimi i dëmeve nga uji” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pronës shkaktuar nga dalja e ujit prej tubacionit, sistemi ngrohës apo spërkatësit ose pajisjeve të tjera për mbrojtjen nga zjarri ose sistemi i mbrojtjes nga zjarri në ndërtesë, ose nga ndonjë gyp kryesor i ujit ose gyp ujqor jashtë ndërtesës.

“Sigurimi nga moti i lig” do të thotë sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të pasurisë nga shiu, uragani, vërshimi, tufani, cikloni, tornado, ose kushtet e tjera klimatike, por nuk përfshin sigurimin që i takon kategorisë së breshrit.

“Sigurimi i transportit detar” ose “sigurimi detar” do të thotë:

- a) Sigurimi në anije, vapor, barka dhe i gjërave të tjera lidhur me to;
- b) Sigurimi i rreziqeve të anijendërtimtarisë, rreziqeve nga lufta e marinës dhe kontratat e mbrojtjes marine dhe sigurimit zhdëmtues;
- c) Sigurimi i transportit të mallrave dhe shpenzimeve lidhur me sigurimin që i takon spektrit të këtij nënëni; dhe
- d) Sigurimi i pronës personale dhe intersave lidhur me eksportimin ose importimin në çfarëdo vendi, ose në transportin bregdetar ose në ujërat e brendshme, përfshirë transportin tokësor, ujqor ose ajror nga pikënisja deri te destinacioni, në lidhje me ndonjë apo çdo rrezik të navigimit, tranzit ose transportues dhe gjatë përgatitjes për dhe gjatë transportimit, dhe gjatë çfarëdo vonese të rastit, ngarkimit ose ringarkimit; megjithatë sigurimi i pronës personale dhe interesit nuk do të konsiderohet si sigurim marinar ose transportues nëse prona është transportuar vetëm nëpër tokë; ose ka arritur destinacionin përfundimtar siç është specifikuar në faturë e zbarkimit ose dokumentet e tjera transportuese; ose i siguruari nuk ka më interes të siguruar në pronë.

### **Neni 3**

#### **Termat dhe shprehjet e përcaktuara me rregulla të veçanta**

Termat dhe shprehjet e përfshira në rregulla të veçanta do të kenë kuptimin përcaktuar në ato rregulla.

### **Neni 4**

#### **Rregullat e përgjithshme për drejtimin e sigurimit**

Ky nen është i zbatueshëm për të gjitha kontratat e sigurimit të negociuara, të shkruara dhe të lëshuara në Kosovë.

#### **1. Kategoritë e autorizuar të sigurimit**

Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësit e sigurimit mund të bëjnë biznes të sigurimit në ato kategori të sigurimit të autorizuar nga Rregullorja e sigurimit dhe nga këto rregulla dhe për të cilat ata janë të licencuar.

#### **2. Kapaciteti kontraktues i palëve në kontratën e sigurimit**

- 2.1. Kapaciteti për të siguruar - çdo person i aftë për të bërë një kontratë, mund të jetë sigures me kusht që të respektojë kërkesat, kufizimet dhe dispozitat e përcaktuara me Rregulloren e sigurimit dhe rregullat e veçanta.
- 2.2. Kapaciteti për t'u siguruar - çdo person, përveç armiqve të shoqërisë (të vendit), mund të sigurohet.

#### **3. Objekt sigurimi mund të jenë - personat dhe rastet e siguroshme**

#### **4. Interesi i siguruar – përgjithësisht**

- 4.1. Mungesa e interesit të siguruar – nëse i siguruari nuk ka interes të siguruar, kontrata është e pavlefshme.
- 4.2. Interesi i mundshëm ose i pritur – një interes i mundshëm ose i pritur që nuk ka bazë në të drejtën e vërtetë të kushtit dhe as me kontratë të vlefshme për të, nuk mund të sigurohet.
- 4.3. Masa e interesit në pronë është shkalla deri në të cilën i siguruari mund të dëmtohet me humbje ose lëndim, përveç në rastin kur prona mbahet nga i

4.4. siguruari si bartës ose si thesar i cili është vlerësuar deri në atë shkallë të vlerës së pronës së mbajtur.

4.5. Kur është i nevojshëm interesi i siguar?

- a) Interesi në pronën e siguar duhet të ekzistojë në kohën kur sigurimi fillon dhe kur humbja ndodh, mirëpo nevoja nuk paraqitet në ndërkohë.
- b) Interesi në jetën dhe shëndetin e të siguarit duhet të ekzistojë kur polisa fillon, mirëpo nevoja nuk ekziston pas kësaj ose kur humbja ndodh.

4.6. Heqja dorë nga nevoja për interes të siguar.

Çdo kusht në polisë të sigurimit për pagesën e humbjes, qoftë kur personi ka ose nuk ka interes të siguar në pronën e siguar, qoftë kur polisa është dëshmi e interesit të tillë, është i pavlefshëm

4.7. Ndikimi i ndryshimit; pezullimi i polisës –

Ndryshimi në interes në cilëndo pjesë të objektit të siguar, që nuk është i shoqëruar me ndryshimin përkatës të interesit në sigurim, pezullon sigurimin në masë të njëjtë derisa interesi në objekt dhe interesi në sigurim të autorizohen për personin e njëjtë. Ky parim nuk zbatohet në:

- a) Në sigurimin e jetës dhe të paaftësisë, ose kur
- b) Ndryshimi në një objekt të siguar pas lëndimit që rezulton në humbje nuk ndikon në të drejtën e të siguarit që të kërkojë dëmshpërblim për humbje.
- c) Ndryshimi në interes në një apo më shumë subjekte të veçanta, të siguruara veçmas.
- d) Ndryshimi i interesit me testament ose trashëgimi, me vdekjen e të siguarit; interesi në sigurim kalon te personi i cili merr interesin e tij në temë.
- e) Transferi i interesit në temë në mes të partnerëve, pronarëve të bashkuar, ose bashkëpronarëve, të siguar bashkërisht për përfitim të përbashkët.



## 5. Negociatat para ekzekutimit

- 5.1.Fshehja është pakujdesi për të komunikuar me personin për të cilin pala di dhe duhet të komunikojë. Fshehja qoftë me qëllim apo jo i jep palës së dëmtuar të drejtën të anulojë kontratën e sigurimit.
- 5.2.Zbulimi i nevojshëm. Çdo palë e kontratës së sigurimit do të komunikojë me tjetrën, në mirëbesim për të gjitha faktet e njohura, të cilat janë ose ai beson të jenë material për kontratë, në bazë të të cilave nuk jep garanci dhe të cilin pala tjetër nuk do ta verifikojë.
- 5.3.Hetimeve e nevojshme. Asnjëra palë e kontratës së sigurimit nuk është e kufizuar të kumtojë informata për çështjet në vijim, përveç si përgjigje të hetimeve të tjetrit:
- a) Ato që i di tjetri.
  - b) Ato që duhet t'i dijë tjetri në ushtrimin e punëve të zakonshme dhe për të cilat pala nuk ka arsye ta injorojë atë.
  - c) Ato nga të cilat tjetri heq dorë prej komunikimit.
  - d) Ato që vërtetojnë ose kanë prirje të vërtetojnë ekzistimin e rrezikut të lënë jashtë nga garancia dhe të cilat nuk janë materiale.
- 5.4.Rëndësia (materialiteti). Rëndësia do të përcaktohet jo sipas rastit, por vetëm sipas ndikimit të mundshëm dhe të arsyeshëm të fakteve në palën së cilës i përket komunikimi në llogaritjen e dëmeve (disavantazheve) të kontratës së propozuar, ose në kryerjen e hetimeve të tij.
- 5.5.Njohuria e supozuar. Secila palë e kontratës së sigurimit supozohet dhe kufizohet të dijë të gjitha shkaqet e përgjithshme të cilat janë të hapura për hetimin e tij baraz me tjetrin, dhe i cili mund të ndikojë si në rreziqet materiale dhe politike të parashikuara, ashtu edhe në praktikatat e përgjithshme të tregtisë.
- 5.6.Përfaqësimi dhe garancia – Përfaqësimi është deklaratë e shkruar apo gojore e bërë nga një palë e kontratës së sigurimit duke iu referuar një fakti ose premtimi; garancia është deklaratë e një kushti. Përfaqësimi dhe garancia bëhen në kohën ose para lëshimit të polisës.

- 5.7. Mashtrimi në një garanci. Mangësia (harresa) e qëllimshme ose mashtruese nga ana e një të siguruari, për të komunikuar informata për çështjet që vërtetojnë osë kanë prirje të vërtetojnë sse garancia është e rreme i japin të drejtën siguruesit që të anulojë kontratën.
- 5.8. Përfaqësimi në të ardhmen është premtim, përveç nëse është bërë vetëm si deklaratë në besim.
- 5.9. Përfaqësimi nuk mund të përcaktojë shprehimisht ndonjë dispozitë të veçantë në kontratë të sigurimit; mirëpo mund të caktojë garanci të nënkuptuar.
- 5.10. Përfaqësimi mund të ndryshojë ose të tërhiqet para se të fillojë sigurimi e jo më vonë. Pasi të bëhet, supozohet se referohen kontratës së sigurimit deri në kompletimin e saj.
- 5.11. Mashtrimi në përfaqësim ndodh kur faktet nuk përputhen me deklaratat ose pohimet. Mashtrimi në përfaqësim duhet të bëhet në anën materiale në mënyrë që t'i jipet palës së dëmtuar e drejta e anulimit të kontratës së sigurimit. Rëndësia e përfaqësimit përcaktohet me të njëjtën rregull sikurse rëndësia e fshehjes.

## **Neni 5** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregull do të hyjë në fuqi më 1 prill 2002.

David Weatherman  
Ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm